



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1287 Prot.

Tiranë, më 7 10 2019

**VENDIM Nr. 225, datë 2.10.2019**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, *VKM Nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave të dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtimet me leje"* (i ndryshuar). Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 11, të datës 2.10.2019, pasi shqyrtoi kërkesën e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Lezhë, për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit "*Godinë banimi 2 kate*" të *Z. Arben Llesh Matrizi, Lagjja Spital, i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Lezhës*,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë kërkesën e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Lezhë, për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit "*Godinë banimi 2 kate*" të *Z. Arben Llesh Matrizi, Lagjja Spital, i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Lezhës*.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR  
ELVA MARGARITI  
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO**